



REPUBLIKA E KOSOVËS / РЕПУБЛИКА КООСОВА / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Jedinstvo Org. Unit	ARPL
Nr. i Prot. Prot. No.	1862-2/25
Nr. i Fajevë Br. Sranica No Pages	Data: Datum: Date: 12.07.25
PRISHTINË / A	
No 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	01.09.2025
REFERENC-Ë:	1862/25 - ZSP 2025 ; ARPL
PËR/ZA/TO:	„EURO BLOK” Sh.p.k Obrangjë, K. Podujevë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D Sekretar i Përgjithshëm i MMPLH-së Z. Fatos QERIMI, Drejtor i ARPL-së Fidan BILALLI, U.D. Udhëheqës i Divizionit të Akteve dhe Financa Ujore
NGA/OD/FROM:	Pellumbesha SPAHIU, Zyrtare e lartë për leje ujore shkarkim të ujit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore, Shkarkim

Të nderuar,

Bazuar në kërkesën me Nr. Protokolli 1862/25 të datës 26.03.2025, nga pala “EURO BLOK” Sh.p.k me nr. të certifikatës së biznesit 810438623 me seli në Obrangjë, Podujevë, për leje ujore shkarkim të ujit, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pas shqyrtimit të lëndës dhe shikimit në vend, ka vendosur si në Vendim, Leje Ujore për shkarkim të ujit të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. L.U.

Datë: 01.09.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

LEJE UJORE

APROVOHET kërkesa e palës **“EURO BLOK” Sh.p.k**, Obrangjë, K.Podujevë me nr. protok. 1862/25, e datës 26.03.2025, për Leje Ujore për shkarkim të ujërave nga fabrika e prodhimit të bllokave të argjilës në ngastrën kadastrale P-71712057-01233-1 në koordinatat: X= 7515077, Y= 4751288 sipas kushteve vijuese:

1. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv dhe pëlqimit ujqor 4204-2/22 të shkarkimit të ujit nga fabrika e prodhimit të bllokave të argjilës.
2. Kohëzgjatja e kësaj leje ujore për shkarkim është e barabartë me periudhën e mbetur të vlefshmërisë së lejes ujore për shfrytëzimin e ujit.
3. Analizat fiziko-kimike të ujërave të shkarkuar që përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - Temperaturë
 - pH
 - SHBO₅
 - SHKO
 - TSS
 - Nitrate, nitrite dhe fosfate

Substanca të tjera specifike të ndotjes, sipas natyrës së aktivitetit industrial duhet të kryhen sipas standardeve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2022 dhe legjislacionin përkatës. Të dhënat e analizave duhet të dorëzohen në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke përfshirë pikat e sakta koordinative të hyrjes së ujërave në impiant dhe pikën e shkarkimit.

Arritja e vlerave kufizuese të shkarkimit të substancave ndotëse të ujërave të ndotura nuk mund të bëhet përmes hollimit.

4. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe llumit dhe ato të shkarkimit, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë.
5. Në rast të ndryshimit të regjimit të ujërave gjatë operimit dhe shkaktimit të dëmeve të mundshme ndaj mjedisit apo palëve të treta, investitori është i obliguar për evidentim dhe kompensim të tyre.
6. Monitorimi duhet të kryhet në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit sipas destinimit të veçantë bazuar në U.A 02/2022 dhe rezultatet e monitorimit duhet të raportohen në MMPHI/ARPL çdo gjashtë muaj.
7. Të gjithë shkarkuesit e ujërave detyrohen të vendosin pajisjen ujëmatëse në të gjitha pikat e shkarkimit.
8. Pajisja ujëmatëse duhet të jetë e tillë që të mundësojë matjen e saktë të ujërave të shkarkuar.
9. Identifikimi i pajisjes ujëmatëse duhet të bëhet me numër të pajisjes dhe pikave të koordinatave.
10. Gjate vendosjes së pajisjes ujëmatëse detyruesi obligohet që vendosjen të bëjë nën mbikëqyrjen e inspektoratit të Ministrisë.
11. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin e ujërave të ndotura, do të caktohet me vendim të posaçëm, në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas U.A. **MMPH –Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor**”.
12. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujqore nuk mund t’u barten personave të tretë, pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujqore.
13. Për vazhdimin e Lejes Ujqore bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujqore.
14. Validiteti i Lejes Ujqore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

Arsyetim

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ujërave, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për leje ujqore për shkarkim; Pala “EURO BLOK” Sh.p.k ka bërë kërkesë me nr. Prot. 1862/25 me datë 26.03.2025, për leje ujqore për shkarkim uji nga fabrika e prodhimit të bllokave të argjilës në ngastrën kadastrale P-71712057-01233-1 Obrangjë, K.Podujevës në koordinatat: X= 7515077, Y= 4751288, andaj ky vendim për leje ujqore për shkarkim është nxjerrë mbi bazën e dokumentacionit tekniko-investiv dhe dokumenteve të poshtëshënuara që pala i ka bashkangjitur kërkesës:

- Aplikacionin për leje ujqore shkarkim uji;
- Dëshmi mbi pagesën e tarifave administrative;
- Certifikaten e regjistrimit të biznesit;
- Vendimin për pëlqim ujqor për shkarkim 4204-2/22;

- Vendimin për leje ujore për shfrytëzim të ujit 4203-2/22;
- Projektin e gjendjes së zbatuar të impiantit;
- Programin e miratuar për monitorimin dhe raportimin mbi vlerësimin e cilësisë së ujërave të ndotura;
- Përshkrimin e zgjedhjes teknike për trajtim të ujit;
- Rregullore për mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe vëzhgimin e objekteve ujore dhe sjelljen në rast të dëmeve dhe avarive;
- Autorizimin mbi përfaqësimin dhe kopjen e ID-së së aplikuesit;
- Kopjen e ID-së së pronarit;
- Kopjen e Pëlqimit në Parim nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit K.Podujevë Nr.07-350/02-0071679/18 për rregullimin e dokumenteve për marrjen e lejes mjedisore për ushtrimin e veprimtarisë;
- Vendimi për leje mjedisore të integruar Nr. 15/6050/ZSP 19.01.2021;
- Kontrata mes palës dhe kompanisë projektuese;
- Certifikata e regjistrimit të kompanisë projektuese;
- Diploma e hartuesve të projektit.

Pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit tekniko-investiv dhe shikimit në vend, është vendosur si në dispozitiv.

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Nr. 1862/25 - ZSP- 2025 Datë: 01.09.2025
Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoriatit të MMPHI-së;
- Komunës së Podujevës;
- Arkivit të MMPHI-së.

U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së

Izedin BYTYQI

